



**PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN
E MATURËS SHETËRORE PROFESIONALE 2015**

**TEORIA PROFESIONALE E INTEGRUAR:
DREJTIMI MËSIMOR "HOTELERI - TURIZËM"**

Janar, 2015

1. Udhëzime të përgjithshme

Ky program orientues ndihmon në përgatitjen e nxënësve të drejtimit “**Hoteleri-Turizëm**”, me strukturë 2+1+1, për provimin me zgjedhje të detyruar “Teori profesionale e integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale 2015. Ai synon orientimin e përgatitjes së nxënësve nëpërmjet përqendrimit në njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të lëndëve teorike profesionale. Njëherazi, ndihmon edhe në verifikimin paraprak të përgatitjes përfundimtare të nxënësve sepse mundëson zhvillimin e testimeve përmbledhëse. Programi orientues për provimin e “Teorisë profesionale të integruar” bazohet në:

- programet orientuese për Provimet Përfundimtare në: drejtimin “Hoteleri-Turizëm”, Niveli I; në profilin “Reception”, Niveli II, “Bar-Restorant”, Niveli II dhe profilin “Guzhine-Pastiçeri”, Niveli II;
- programet e lëndëve teorike profesionale të drejtimit “Hoteleri-Turizëm”, Niveli III (klasa e 13-të);
- Udhëzimin e përbashkët të MAS dhe MMSR nr. 2, datë 06.02.2015 “Për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale 2015 në Republikën e Shqipërisë”.
- Rregulloren e Maturës Shtetërore 2015 në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhërin e Ministrit nr.61, datë 10.02.2015.”.

Në të përfshihen njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të këtyre programeve. Për Bazat e sipërmarrjes, janë marë parasysh vetëm njohuritë e reja dhe jo veprimtaritë praktike.

2. Udhëzime për zbatimin e programit

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes sepse evidenton dhe përforcon njohuritë teorike, por dhe aftësitë e nxënësve për aplikimin e njohurive në situata të njohura e të reja, analizën dhe vlerësimin e këtyre situatave. Specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të kësaj lënde, nuk duhet të përfshijnë për vlerësim tema mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Përgatitja e nxënësve për provim të bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.

Gjatë punës për përgatitjen e nxënësve për provimin me zgjedhje të detyruar “Teori profesionale të integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale, është e rëndësishme që herë pas here mësuesi të zhvillojë teste të nxënësve të tij, me teste që mund t’i hartojë vetë duke u bazuar në modelet e mëparshme të testeve të Maturës Shtetërore për teorinë profesionale.

Testi për drejtimin mësimor “**Hoteleri-Turizëm**” do të ndërtohet në mënyrë të tillë ku të jenë të përfshira të tri nivelet e vështirësisë: niveli bazë, niveli mesatar dhe niveli i lartë. Njëkohësisht, edhe shpërndarja e pikëve në test do të jetë në varësi të përqindjeve që zë

çdo nivel. Gjatë hartimit të njësive të testit duhet të mbahen parasysh synimet e përgjithshme, në skeletkurrikulat përkatëse, të temave të përzgjedhura në këtë program.

Nxënësit duhet të kenë parasysh se lënda, e cila ka peshën më të madhe në këtë program orientues të Maturës Shtetërore Profesionale, në test do të përfaqësohet nga një numër më i madh pyetjesh.

3. Lëndët dhe temat përkatëse

Në programin orientues të provimit të “Teorisë profesionale të integruar” në kuadrin e provimit me zgjedhje të detyruar “Teori profesionale e integruar”, të Maturës Shtetërore Profesionale, për drejtimin mësimor “Hoteleri-Turizëm”, do të përfshihen programet e lëndëve profesionale të mëposhtëme:

1. Organizim i ndërmarrjeve hoteliere, kl. 10 dhe 11.
2. Turizmi dhe mjedisi, kl.10.
3. Trashëgimia kulturore dhe historike, kl.11.
4. Bazat e sipërmarrjes, kl. 12 dhe 13.
5. Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm, kl. 13.
6. Gjeografi turistike, kl. 13.
7. Ekonomi e turizmit, kl. 13.
8. Kontabilitet, kl. 13.

Tabela 1: Lëndët dhe peshat përkatëse në programin orientues

Nr	Lënda	Vëllimi i orëve për çdo lëndë	Peshat në %
1	Organizimi i ndërmarrjeve hoteliere	90	32
2	Turizmi dhe mjedisi	50	17
3	Trashëgimi kulturore dhe historike	30	11
4	Bazat e sipërmarrjes	19	7
5	Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm	14	5
6	Gjeografi turistike	24	9
7	Ekonomi e turizmit	28	10
8	Kontabilitet	25	9
	TOTALI	280	100%

Temat sipas lëndëve janë:

a) “Organizimi i ndërmarrjeve hoteliere” kl. 10 dhe 11:	(90 orë)
• Klasifikimi i ndërmarrjeve hoteliere	12 orë
• Ndërtimi strukturor i hoteleve	10 orë
• Pajisjet dhe mobilimi i hoteleve	10 orë
• Struktura organizative e personelit në hotele	8 orë
• Funkcionet dhe detyrat e personelit në hotele	14 orë
• Klasifikimi i ndërmarrjeve gastronomike	5 orë
• Mënyrat dhe dokumentet për inventarizimin fizik të pajisjeve dhe mjeteve në sektorët e hotelit	10 orë
• Mjetet dhe format e pagesave në ndërmarrjet e hoteleri-turizmit	5 orë
• Llojet e faturave që përdoren në restorant, bar, reception	10 orë
• Dokumentacioni i punonjësve në ndërmarrjet hoteliere	2 orë
• Siguracionet e punonjësve në hoteleri turizëm	2 orë
• Paga e punonjësve të hoteleri turizmit sipas legjislacionit shqiptar	2 orë
b) “Turizmi dhe mjedisi” , kl.10:	(50 orë)
• Kuptimi i turizmit dhe rëndësia e zhvillimit të tij	8 orë
• Komponentët bazë për zhvillimin e turizmit	10 orë
• Llojet dhe format e turizmit	10 orë
• Klasifikimi i ndërmarrjeve turistike dhe ndërmjetësit	8 orë
• Marrëdhënia turizëm mjedis	14 orë
c) “Trashëgimi kulturore dhe historike” , kl. 11:	(30 orë)
• Kuptimi mbi trashëgiminë materiale dhe historike, elementët përbërës	4 orë
• Trashëgimia materiale shqiptare	5 orë
• Trashëgimia kulturore shpirtërore	5 orë
• Krijimtaria popullore	9 orë
• Trashëgimia natyrore	5 orë
• Trashëgimia materiale kulturore dhe turizmi	2 orë
d) “Bazat e sipërmarrjes” , kl. 12 dhe 13:	(19 orë)
• Tregu dhe sjellja konsumatore	5 orë
• Legjislacioni i punës	5 orë
• Menaxhimi i informacionit	4 orë
• Menaxhimi i marketingut	5 orë
e) “Mjedis dhe zhvillimi i qëndrueshëm” , kl. 13:	(14 orë)
• Burimet kryesore të mjedisit dhe degradimi mjedisor	3 orë

• Ndikimi i veprimtarisë së njeriut në mjedis	3 orë
• Zhvillimet demografike dhe mjedisi	4 orë
• Shoqëria e konsumit dhe mbetjet	4 orë
f) “Gjeografi turistike”, kl.13:	(24 orë)
• Kuptimi gjeografik mbi turizmin	4 orë
• Pasojat dhe efektet gjeografike të turizmit	5 orë
• Oferta gjeografiko-natyrore e Shqipërisë në fushën e turizmit	5 orë
• Oferta gjeografiko-kulturore e Shqipërisë në fushën e turizmit	5 orë
• Problemet e sotme dhe e ardhmja e turizmit në Shqipëri	5 orë
g) “Ekonomi e turizmit”, kl.13:	(28 orë)
• E drejta e turizmit dhe legjislacionit turistik. Ndërmarrja turistike	5 orë
• Tregu turistik-kërkesa (sjellja konsumatore)	8 orë
• Tregu turistik-oferta	8 orë
• Problemet bashkëkohore makroekonomike	5 orë
• Mbrojtja e konsumatorit turist dhe legjislacioni kombëtar dhe ndërkombëtar në mbrojtje të tij	2 orë
h) “Kontabilitet”, kl.13:	(25 orë)
• Bilanci	5 orë
• Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	10 orë
• Kostot direkte dhe indirekte	5 orë
• Marzhi i kontributit	5 orë